

GRATË NË POLITIKË

(Pa)Barazia gjinore në
politikë dhe vendimmarrje



POLITIKË
KOMUNË
INSTITUCIONE
QEVERI
KUVEND
PRESIDENCE

(PA)BARAZIA GJINORE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Ky artikull është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë artikull janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Hulumtime të Politikave në Ballkan (BPRG)

(Pa)Barazia gjinore në politikë dhe vendimmarrje


Në një shoqëri ku pabarazia dhe stereotipet gjinore janë të ngulitura në kulturën e përgjithshme dhe në raportet ekonomike, intervenimi politik bëhet më se i domosdoshëm. Në Kosovë, pak progres është arritur në luftimin e pabarazisë gjinore. Në fakt në disa aspekte situata është përkeqësuar nga politikat qeverisëse, edhe atë në të gjitha nivelet. Trendi i përfshirjes së grave në pozita drejtuese dhe i përfshirjes së pamjaftueshme në pozitat përfaqësuese ka shënuar ulje, dhe angazhimi për rritje të barazisë gjinore në sferën politike dhe publike mbetet sipërfaqësor dhe minimalist. Pozitat udhëheqëse në institucione dhe politikë janë zënë nga burrat dhe intervenime të fuqishme politike kërkohen për të ndryshuar këtë gjendje.

Qasja e barabartë e burrave dhe grave në vendimmarrje është parakusht i domosdoshëm për qeverisje demokratike. Pjesëmarrja e balancuar e të dy gjinive në vendimmarrjen politike dhe publike është një nga faktorët kyç që mundëson barazinë gjinore, duke avancuar kështu realizimin e të drejtave të njeriut dhe llogaridhënien më të mirë për gratë. Tani më, është dëshmuar se gratë në pozita vendimmarrëse përbëjnë faktorë të rëndësishëm në krijimin e politikave më të mira që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave në veçanti, dhe atë shoqërore në përgjithësi. Angazhimi për përfaqësim më të barabartë në institucione ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e padrejtësive dhe rritjen e kohezionit shoqëror.

Kosova ka ligjin për barazi gjinore më të avancuar në rajon. Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) mbron dhe vendos barazinë ndërmjet gjinive në [themel të zhvillimit demokratik të shoqërisë kosovare dhe ofron mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe të gjitha fushat e jetës shoqërore](#). LBGJ obligon të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe institucionet e tjera publike të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor prej 50 përqind për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse. Ligji poashtu, parasheh sanksione për dështim të zbatimit të dispozitave të tij.

Intervenimi politik është më se i domosdoshëm për përmirësimin e përfaqësimit gjinor

Por në praktikë ndodh krejt ndryshe. Përfshirja e grave në vendimmarrje dhe udhëheqje, qoftë brenda sektorit publik apo privat, vazhdon të mbetet sfida e madhe. Pabarazia e dukshme gjinore pengon gratë që të kontribuojnë dhe ndikojnë në agjendat e zhvillimit. Pabarazia ekonomike gjinore në Kosovë vlerësohet të jetë [më e larta në Evropë](#). Edhe pse gratë përbëjnë 52.1 përqind të numrit të përgjithshëm të kosovarëve me arsimim universitar, krahas 47.9 përqind të burrave, në punësim ato marrin pjesë me vetëm 12.7 përqind kundrejt 46.6 përqind burrave. Edhe në rastet kur ato janë të punësuar, mbesin shumë pak të përfshira në nivele vendimmarrëse. Sanksionimi ligjor, ndërkohë mbetet ende i pa zbatuar.



*Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës


Politika vazhdon të konsiderohet fushë e dedikuar për burrat. [Paragjykimet gjinore, besimi i përgjithshëm se burrat janë udhëheqës më të mirë dhe mungesa e përkrahjes politike janë disa nga shkaqet që pamundësojnë ose pengojnë shumë promovimin e grave në pozita vendimmarrëse.](#) Po ashtu, puna e papaguar - mirëmbajtja e shtëpisë dhe kujdesi për familjarët - dhe mungesa e qendrave të kujdesit ditore për fëmijë, i vendosin gratë dhe burrat në raport shumë të pabarabartë lidhur me kohën e disponueshme për t'iu dedikuar angazhimit politik e publik. Kështu gratë nuk arrijnë të angazhohen sa duhet [në aktivitete të rrjetëzimit politik dhe ngritje të fondeve, gjë që iu kufizon qasjen në burime për financimin e fushatave të tyre politike.](#)

Megjithëse, lufta kundër pabarazisë dhe diskriminimit gjinor duhet të zhvillohet në fusha dhe dimensione të ndryshme, një pikënisje e mirë do të ishin institucionet kryesore politike. Kjo ngase ndikimi shoqëror i këtyre institucioneve është jashtëzakonisht i madh, për të mos thënë përcaktues. Prandaj, më poshtë është paraqitur një analizë mbi përfshirjen e grave në institucionet kryesore të Republikës së Kosovës, duke filluar nga Presidenca për të vazhduar me Kuvendin, Qeverinë, komunat dhe partitë politike. Në fund të kësaj analize janë listuar disa rekomandime për avancimin e pozitës së gruas dhe arritjen e barazisë gjinore në politikë dhe vendimmarrje.

Presidenca

Në vitin 2011 si rezultat i një marrëveshjeje ndërpartiake për të zgjidhur krizën politike mes burrave më të fuqishëm në politikë, [Kuvendi emëroi Presidenten e parë grua, duke u bërë kështu vendi i parë në rajon që pozitën më të lartë shtetërore ia beson një gruaje.](#) Gjinia dhe pavarësia e saj politike u pa si zgjidhje e duhur e krizës nga përfaqësuesit ndërkombëtar kundrejt luftës së burrave që synonin pushtetin me çdo kusht. Gjatë mandatit të saj, Atifete Jahjaga arriti që shumë çështje që prekin të drejtat e gruas t'i vë në fokus të Presidencës. Për herë të parë, krimet e dhunës seksuale gjatë luftës u bënë pjesë e debatit politik dhe shoqëror. Ndryshe nga koha e Presidentes Jahjaga, pasuesi i saj, Presidenti Hashim Thaçi, nuk ka treguar ndonjë interesim të mirëfilltë që të vazhdojë debatin e filluar për mbrojtjen dhe fuqizimin e grave, duke e zbehur kështu përkushtimin institucional ndaj promovimit të të drejtave të tyre.

Numri i këshilltarëve politik në kabinetin e Presidentit Thaçi



Ky dallim në qasje në mes dy Presidentëve, vërehet qartazi në përzgjedhjen e këshilltarëve politikë. Derisa në vitet 2013, 2014 dhe 2015 Presidenca kishte deklaruar se numri i grave të angazhuara në pozitat e këshilltarëve ishte i barabartë me atë të burrave, në mandatin e Presidentit Thaçi [të gjithë 11 këshilltarët politikë të Presidentit janë burra.](#)

Mirëpo, kur flasim për pozita të larta vendimmarrëse brenda Presidencës, pavarësisht se kush ka qenë president/e, pabarazia e përfaqësimit nuk ka ndonjë dallim të madh. Gratë edhe nëse kanë arritur të kenë përfaqësim të mirë në rolet konsultative nën udhëheqjen e Presidentes Jahjaga, nga viti 2013, në Zyrën e Presidentit asnjë grua nuk është emëruar në pozitë të lartë vendimmarrëse.

Gjatë viteve 2013-2016, në nivel të lartë drejtues dhe në nivel drejtues, nga 32 pozita, 18 udhëhiqeshin nga burrat kurse 14 nga gratë.

Mandati i ish-Presidentes Jahjaga kishte ndikim pozitiv në luftimin e stereotipeve gjinore që sugjerojnë se gratë nuk kanë aftësi drejtuese dhe njëkohësisht shpërfaqin paragjykimet e rrënjësura për angazhimin e grave në politikë. Ish-Presidentja Jahjaga, gjatë mandatit të saj shumë shpesh ishte cak i komenteve dhe fytyrjeve seksiste, deri tek portretizimi objektizues. Një shembull kulminant për këtë ishte vizatimi anonim në një mur ndërtese i një grafiti seksist. [Ndaj sulmeve të tilla kundër ish-Presidentes patën reaguar ashpër disa organizata për të drejtat e grave](#), por nuk kishte pasur reagim të menjëhershëm nga drejtuesit e institucioneve apo partive politike, gjë që përbënte një legjitimim të heshtur të këtyre sulmeve me bazë në paragjykime dhe stereotipe gjinore.

Kuvendi i Kosovës

Përfaqësimi i grave në Kuvendin e Kosovës është bërë i mundur përmes kuotës (nga viti 2000), e cila iu rezervon atyre 30 përqind të ulëseve, kundrejt burrave, të cilët praktikisht e kanë pothuajse të garantuar zënien e 90 ulëseve të tjera të Kuvendit të Kosovës. Edhe pse shpeshherë efekti i kuotës gjinore është kontestuar, ka mjaft raste që gratë të cilat fillimisht janë zgjedhur deputete për shkak të kuotës, më vonë këtë synim e kanë arritur edhe pa të. Një efekt i tillë është vërejtur edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2017, ku gratë fituan 38 prej 120 ulëseve në Kuvend; 17 prej tyre i fituan vendet në sajë të kuotës e 21 tjera i fituan vendet e tyre me meritë nga beteja me trefishin e numrit të kandidatëve burra.

[Përderisa përfaqësimi i grave në Kryesinë e Kuvendit është po ashtu i rregulluar me rregulloren e Kuvendit](#), në anën tjetër, hapësira për gratë në drejtimin e grupeve parlamentare është shumë e kufizuar. Në legjislaturën aktuale [të gjitha grupet parlamentare udhëhiqen nga burrat](#). Ky është një fakt më shumë që tregon se si partitë politike nuk kanë bërë asgjë më shumë për përfaqësim të barabartë gjinor nga ajo që iu kërkohet me ligj. Për shembull, pothuajse asnjë nga partitë politike apo koalicionet parazgjedhore nuk kanë pasur në listat e tyre zgjedhore kandidatë gra më shumë se 30 përqind - aq sa i obligon Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në zgjedhjet e vitit 2017, 21 prej 38 grave deputete kanë fituar vendet në kuvend me meritë, janë zgjedhur drejtpërdrejtë

Përkundër diskutimeve të ndryshme rreth efektivitetit të kuotave gjinore, viteve të fundit ka filluar të hapet diskutimi për rritjen e kuotës së përfaqësimit gjinor, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, i cili kërkon pjesëmarrje të barabartë të grave në çdo nivel vendimmarrës apo përfaqësues në institucionet e Kosovës. Megjithatë, ky ligj nuk është marrë parasysh asnjëherë kur janë përpiluar listat zgjedhore, ngase është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, të cilit i është dhënë vazhdimisht përparësi. [Këtë e ka ngritur si shqetësim edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili ka kërkuar aplikimin e Ligjit për Barazi Gjinore në mënyrë që listat zgjedhore të përbëhen nga 50 përqind gra dhe 50 përqind burra](#).

Gjuha diskriminuese dhe [seksiste e përdorur në Kuvend nga Kryeparlamentari dhe deputetë burra nuk është e rasteve të izoluara](#). Por, mos-dënimi i gjuhës së tillë [konsiderohet](#) të ketë ndikuar në krijimin e një mjedisi ku diskriminimi gjinor është normalizuar.

Pjesëmarrja e zëshme dhe vendimmarrja e pavarur e deputeteve në bërjen e ligjeve e politikave që prekin çështjet gjinore vazhdon të mbetet sfidë. Shumë gra deputete nuk tregojnë shkëputje nga qasja patriarkale e kolegëve të tyre partiakë, edhe në rastet e vendimeve të rëndësishme që janë direkt të lidhura me të drejtat e grave dhe çështjet gjinore. [Një nga portretizimet më të mira të dështimit të deputeteve për të vendosur ndryshe nga kolegët e tyre burra u shënuar në vitin 2013](#), gjatë diskutimeve për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ligji kaloi në vitin 2014, por jo para se të kundërshtohet, sidomos nga radhët e deputeteve të PDK-së, të cilat dështuan të kalonin përtej diskursit të krijuar nga bashkëpartiakët e tyre burra lidhur me viktimat e dhunës seksuale.


Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës si mekanizëm përcjellës i zërit të grave i cili në objektivin e vet ka fuqizimin e gruas në politikë dhe monitorimin e zbatimit të LBGJ-së dhe ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me përparimin e pozitës së gruas në shoqëri, ka treguar një unitet më të madh të deputeteve nga partitë politike. Mirëpo mesazhet dhe veprimet e këtij grupi dështojnë të jenë shtytëse drejt barazisë gjinore. Grupi i Grave është kritikuar vazhdimisht për mungesë të reagimeve ndaj qasjes fyese dhe diskriminuese të disa deputetëve në Kuvend. Për të rritur rolin e tyre në Kuvend dhe politikë, gratë deputete duhet me vendosmëri të marrin iniciativë të cilat shkojnë përtej linjave të subjekteve të tyre politike.

Qeveria

Nga viti 2012 deri më 2018, numri edhe ashtu i vogël i grave në pozita të larta vendimmarrëse brenda Qeverisë u zvogëluar ndjeshëm. [Në vitin 2015 \(5.6%\) dhe 2016 \(5.7%\), kjo përqindje ishte ndjeshëm më e vogël krahasuar me tri vitet e mëparshme](#), ku përqindja e grave ishte pothuajse dyfish më e madhe (9.8% në vitin 2012). Kjo u përmirësua lehtësisht nga pika më e ulët e shënuar në vitin 2015, ku në vitin 2018 gratë mbajnë 11.9 përqind të pozitave të larta vendimmarrëse (Sektetar/e i/e Përgjithshme, Kryeshef/e Ekzekutiv/e, Drejtor/e Ekzekutiv/e). Megjithatë, gjatë këtyre shtatë viteve rritja ishte e papërfillshme (2.1%) duke pasur parasysh

Qeveria e Kryeministrit Ramush Haradinaj ka vetëm një ministre grua prej 21 ministrave

Pozitat e larta vendimmarrëse në Qeveri sipas gjinisë



*Të dhënat zyrtare nga Qeveria e Kosovës

**Në ligjeshaturën aktuale
gratë përbëjnë 32
përqind të deputetëve
të Kosovës, ndërsa
në vitin 2018 Kuvendi
emëroi një ekip
negociator vetëm me 11
burra, pa asnjë grua**

se në mandatin aktual Qeveria ka krijuar dy ministri të reja dhe pozita shtesë, gjë që do të duhej të ofronte një mundësi për përfshirje më të madhe të grave.

Me vetëm një ministre grua, kabineti qeveritar i Kryeministrit Ramush Haradinaj shënon shkallën më të ulët të përfaqësimit gjinor (grave) në nivelin vendimmarrës të ekzekutivit të shtetit. Pas dorëheqjes së ish-Ministres së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, e cila më vonë u bë Këshilltare e Kryeministrit, Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha mbetet e vetmja grua ministre nga 21 ministri.

Krijimi i qeverisë në vitin 2017 nga një koalicion i gjerë politik, të cilit i është dashur t'i akomodoj kërkesat e shumë partnerëve, bëri që të gjitha pozitat e larta të ndahen për burrat e fuqishëm të subjekteve politike të koalicionit qeveritar. Si rrjedhojë, përfaqësimi gjinor nuk zuri fare vend në diskutimet për ndarjen e pushtetit.

Qeveria e Haradinajt është përfolur vazhdimisht për numrin e madh të zëvendësministrave dhe këshilltarëve politik të kryeministrit të Kosovës, pozita të cilat janë shfrytëzuar për të shtuar hisen dhe akomoduar interesat e partnerëve të koalicionit. Por, edhe me këtë rritje enorme të numrit të ministrave dhe zëvendësministrave, nuk u krijua fare hapësirë për përfshirjen e grave në pozitat vendimmarrëse qeveritare. Të dhënat e publikuara në uebfaqet e 20 prej 21 ministrave, tregojnë se nga 69 pozitat e zëvendësministrave (numri i të cilëve është shumë më i madh, raportohet të jetë rreth 80) vetëm 6 pozita të tilla u janë ndarë grave. Gjendja është e ngjashme edhe tek përfshirja e grave në kabinetet e ministrave, departamentet e tyre si dhe trupat këshilluese.

Gratë mbeten jashtë të gjitha proceseve të mëdha politike, përfshirë edhe ato të ndërtimit të paqes. Dialogu teknik me Serbinë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian deri në një fazë është udhëhequr nga Edita Tahiri. Sidoqoftë, roli i saj në krye të dialogut nuk ka pasur efektin e njëjtë sikurse Jahjaga ndaj çështjeve gjinore. Formatu rigjid i dialogut vazhdimisht është kritikuar në shumë aspekte. Kjo ka bërë që procesi i dialogut të ofrojë pak mundësi për integrimin e perspektivës gjinore. Në debatin aktual për fazën përfundimtare të dialogut, i cili ka për qëllim ndërtimin e paqes mes dy vendeve të dala nga lufta, gratë apo pikëpamjet e tyre mungojnë plotësisht. Duke pasur parasysh rëndësinë gjithëpërfshirëse dhe standardet ndërkombëtare për përfshirje të grave në procese të tilla, të riafirmuara sidomos përmes rezolutave 1325 dhe 1820 të Kombeve të Bashkuara, dialogu Kosovë - Serbi mbetet plotësisht përjashtues ndaj perspektivës së grave dhe të rinjëve.

Së fundmi, Kuvendi i Kosovës emëroi një ekip negociator për dialogun me Serbinë. Procesi i emërimit dhe përbërja e tij kanë dy të meta themelore. [Ekipi 11 anëtarësh nuk është mjaftueshëm politikisht gjithëpërfshirës](#). Edhe më shqetësues është fakti se [9 emërimet e bëra deri tani nuk përfshijnë asnjë grua](#).


Barazia gjinore nënkupton edhe ndarje të barabartë të resurseve publike për vajzat e djemtë dhe gratë e burrat. [Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, i obliguar përmes Ligjit për Barazi Gjinore, kërkon përfshirjen e perspektivës gjinore në atë se si mbledhen dhe shpenzohen resurset publike](#). Qeveria ende nuk ka arritur zbatim të mirëfilltë të kësaj kërkesë ligjore, e cila duhet të aplikohet mbi bazën e analizës dhe përfshirjes gjinore.

Pjesëmarrja e ulët e grave në politikë dhe aktivitete politike ndikohet edhe nga angazhimi i tyre në kujdesin shtëpiak. Dispozitat e tanishme ligjore të pushimit të lehonisë, sipas të cilave punëdhënësit obligohen të paguajnë për gjashtë muaj, theksohen si shkaqe të diskriminimit ndaj grave në punësim, duke shkaktuar shkallë më të lartë të papunësisë së grave. Projekt-ligji i ri i Punës së shpejti pritet të kalojë në Kuvend dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe akterët tjerë politikë e kanë mundësinë të finalizojnë atë me dispozitat e rekomanduara nga shoqëria civile, të cilat do të sfidonin rolet tradicionale gjinore në familje, shoqëri dhe politikë, si dhe do të ndikonin në pjesëmarrje më të madhe të grave në punësim dhe në jetën politike e publike në Kosovë.

Komunat

Përfshirja e grave në nivelin e qeverisjes lokale mbetet edhe më sfiduese. Edhe pse për Asambltetë Komunale vlen kuota e njëjtë sikurse për Kuvendin e Kosovës dhe gratë përbëjnë 30 përqind të përfaqësuesve në këto asamble, aktualisht asnjë komunë nuk udhëhiqet nga ndonjë grua.


Përqindja e kandidatëve për kryetar të komunave në zgjedhjet lokale të vitit 2017, sipas gjinisë



Në zgjedhjet e fundit komunale (2017), nga 204 kandidatë për kryetarë komunash për udhëheqjen e 38 komunave të Kosovës, vetëm 8 prej tyre ishin gra (3.9%). Vetëm Mimoza Kusari - Lila e Alternativës (ish anëtare e AKR-së) dhe Valdete Idrizi nga Partia Demokratike e Kosovës arritën që të kalojnë në raund të dytë të zgjedhjeve. E para ishte kryetare e komunës së Gjakovës deri në zgjedhje dhe e dyta iu kishte bashkangjitur PDK-së në prag të zgjedhjeve; asnjëra nuk fitoi në raundin e parë. Edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2013, vetëm nëntë kandidate ishin gra.

Pra, përfaqësimi i grave në proceset zgjedhore lokale është minimal, duke mos kaluar 4 përqindëshin. Edhe në ato raste kur gratë kandidohen, atyre nuk u jepet rasti që të kandidojnë në rajonet apo komunat e fuqishme elektorale. Ato përgjithësisht kandidohen në ato komuna apo rajone ku ka pak gjasa që të fitojnë, ndërkaq bastionet partiake zakonisht rezervohen për burrat. Për shembull, në zgjedhjet e vitit 2017, PDK i kishte dhënë hapësirë një gruaje që të kandidojë në Pejë, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e kishte bërë të njëjtën në Drenas, ndërkohë që as Peja për PDK-në dhe as Drenasi për AAK-në nuk paraqesin komuna ku këto parti kanë traditë fitoreje.

Udhëheqja e Drejtorive në Komunën e Prishtinës sipas gjinisë



Përveç pozitive drejtuese në komuna, drejtoritë komunale po ashtu reflektojnë pabarazi të thellë gjinore duke u lënë grave një numër shumë të vogël të pozitive drejtuese. Në kryeqytet, nga 12 drejtoritë komunale, vetëm 4 vazhdojnë të udhëheqen nga gratë. Ndërkaq, në gjashtë komunat e tjera më të mëdha, numri mesatar i drejtorive të drejtuara nga gratë është dy apo tre.

Zyrtarët për Barazi Gjinore në komuna dhe ministri janë pjesë e mekanizmave kryesorë kombëtarë për barazi gjinore, së bashku me Agjencinë për Barazi Gjinore. Zyrtarët përballen me shumë sfida në kryerjen e detyrave, prej mungesës së buxhetit e deri te mungesa e vullnetit politik nga ana e Qeverisë për t'i përfshirë ata në bërje të ligjeve dhe politikave me perspektivë gjinore. Në anën tjetër, fakti që shumica e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në nivel lokal dhe qendror janë gra, tregon për tendencën e institucioneve që çështjet e grave t'ua lënë në dorë vetëm grave, duke mos pritur që angazhimin për barazi gjinore ta bëjnë edhe burrat.

**Kosova ka 38 komuna,
por asnjë grua nuk
udhëheq në ndonjërin
prej tyre**

Është e domosdoshme që komunat të planifikojnë dhe zbatojnë politika dhe mbështetje të madhe buxhetore, nëse duan të zvogëlojnë hendekun e pabarazisë gjinore. Ato duhet të krijojnë politika të mirëfillta në zonat rurale, ku papunësia dhe diskriminimi janë shumë më të theksuara.

Partitë politike

Partitë politike kanë rol vendimtar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe rrjedhimisht edhe promovimin e vlerave demokratike. Përfshirja e grave në politikë e vendimmarrje, si dhe vendosja e tyre në pozita udhëheqëse në masë të madhe varet nga partitë politike dhe reflekton pozitën e gruas brenda tyre. Përfaqësimi i ulët i grave dëshmohet edhe nga fakti se përveç Mimoza Kusari-Lilës që bashkëdrejton Partinë Alternativa, asnjë grua tjetër momentalisht nuk e udhëheq ndonjë parti politike.

Në anën tjetër, në aspektin programor, pothuajse asnjëra nga subjektet politike nuk e trajtojnë në mënyrë serioze dhe të elaboruar çështjen e pabarazisë gjinore. Të gjitha partitë që kanë program të publikuar, pabarazinë gjinore e përshkruajnë shkurt, në nivel të përgjithshëm dhe nuk paraqesin ndonjë propozim të detajuar se si ta zgjidhin këtë çështje. Kjo lë të kuptohet që kësaj çështjeje as për së afërmi nuk i kushtohet vëmendja e barabartë me temat e tjera që trajtohen në këto programe.

Bazuar në dokumentet e tyre themelore (statuti dhe programi) në përgjithësi partitë politike nuk i kanë dhënë vëmendje të veçantë përfshirjes së grave. Kjo pasqyrohet edhe në përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të partive. Në shumicën prej tyre nuk ka kuota të përfaqësimit gjinor në organet vendimmarrëse të cilat përgjithësisht përbëhen nga burrat. Shumica e subjekteve politike në Kosovë angazhimin e grave e rregullojnë përmes krijimit të forumeve të veçanta për gratë në kuadër të partisë. Përfaqësimi i ulët dhe mospërfshirja e grave në organet vendimmarrëse të subjekteve, e kombinuar me mungesën e programeve serioze për rritjen e barazisë gjinore, pasqyrojnë më së miri dështimin e idesë së përfshirjes së grave në politikë, vetëm përmes krijimit të këtyre forumeve. Partitë politike janë shumë larg përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për Barazi Gjinore.

Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) - partisë më të madhe parlamentare - nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti. Statusi i saj përcakton që

kryetarja e Forumit të Gruas së LDK-së është automatikisht edhe anëtare e Këshillit të Përgjithshëm dhe e kryesisë së saj. [Mirëpo të gjitha degët \(38\) e LDK-së drejtohen nga burrat, kurse vetëm 4 prej 23 anëtarëve të kryesisë së partisë janë gra.](#)

Njësoj, statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), partisë së dytë parlamentare, nuk parasheh kuota të përfaqësimit gjinor në organet e saj. [Nga 50 anëtarët e kryesisë vetëm 13 janë gra.](#) Gjendja është e njëjtë edhe në Këshillin Drejtues të saj, ku gratë mbajnë vetëm 38 vende nga 184 anëtarë sa ka ky Këshill.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk ka forum të gruas sipas modelit të subjekteve të tjera, por angazhimin e gruas e rregullon përmes sekretariateve të gruas aktiviste në secilin nivel të organizimit. Mungesën e forumit, LVV e arsyeton me atë se trajtimi i burrave dhe grave duhet të bëhet në mënyrë të barabartë, në varësi të kontributit të tyre. Në pozitë drejtuese, kjo parti ka një grua nënkryetare dhe një grua sekretare organizative, por çalon sa i përket përfshirjes së grave në nivele tjera drejtuese. Vetëm 4 nga 33 degët e kësaj partie drejtohen nga gratë, kurse vetëm 7 gra përbëjnë kryesinë e saj 23 anëtarëshe.

Nisma Socialdemokrate (NISMA), sikurse edhe shumica e subjekteve tjera, çështjen e pjesëmarrjes së barabartë gjinore nuk e rregullon me kuota por vetëm me organizatën e veçantë të gruas (Organizata Nisma e Gruas për Kosovën). Kurse, rreth përfaqësimit aktual të grave në organet e saj drejtuese nuk ka ndonjë informacion në faqen zyrtare. E njëjta vlen edhe për Aleancën Kosova e Re (AKR) dhe njësoj, as ky subjekt nuk parasheh kuota gjinore dhe çështjen e përfshirjes së gruas e trajton përmes Forumit të Gruas së AKR.

Të vetmet subjekte politike në Kosovë që në kuadër të statutit të tyre aplikojnë kuota gjinore janë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD). Kjo e fundit që nga themelimi i saj në vitin 1990, e ka të përcaktuar me statut që të gjitha organet drejtuese, ku përfshihen Këshilli Drejtues dhe Kryesia duhet të kenë përfaqësim minimal prej 40 përqind të secilës gjini. Megjithatë ky subjekt ishte në shuarje e sipër, deri kur të 12 deputetët e larguar nga Vetëvendosja, të udhëhequr nga kryetari i Komunës së Prishtinës Shpend Ahmeti, morën udhëheqjen e saj dhe riaktivizuan këtë subjekt të fjetur. Meqë partia ende është në proces të ri-formatizimit dhe pa platformë politike, trajtimi i barazisë gjinore nga PSD-ja ende mbetet i paqartë.

Ndërkaq, që nga vitit 2018, statuti i ri i AAK-së (partia e udhëhequr nga Kryeministri Haradinaj) përcakton që 30 përqind e organeve të zgjedhura të partisë duhet të përbëhen nga gratë. Sidoqoftë, [në kryesinë 60 anëtarëshe të AAK-së, vetëm 12 janë gra, gjë që nënkupton më](#)

LDK	PDK	LVV	NISMA	AAK	PSD	AKR
Nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti.	Nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti	Nuk ka forum të gruas Ka sekretariate të gruas aktiviste	Nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti	Statuti i ri i AAK-së përcakton që 30% e organeve të partisë duhet të përbëhen nga gratë	Statuti i PSD-së që nga fillimi (1990) ka përcaktuar 40% pjesëmarrje të secilës gjini	Nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti
38 degët e saj drejtohen nga burrat	Nga 50 anëtarët e kryesisë vetëm 13 janë gra	Vetëm 4 nga 33 degët e kësaj partie drejtohen prej grave	Nuk ka informacion rreth përfaqësimit aktual të grave në organet e saj drejtuese	Në kryesinë 60 anëtarëshe të AAK-së, vetëm 12 janë gra ose më pak se 30%	Që nga ri-aktivizimi i partisë, trajtimi i barazisë gjinore mbetet i padefinuar ende	
Vetëm 4 prej 23 anëtarëve të kryesisë së partisë janë gra	Gratë mbajnë vetëm 38 vende nga 184 sa ka këshilli drejtues i saj	Vetëm 7 prej 23 anëtarëve të kryesisë së partisë janë gra		Asnjëra nga 35 degët nuk drejtohen nga gratë		

[pak se 30 përqind](#). Ndërsa, asnjëra nga 35 degët e saj nuk drejtohet nga gratë. Forumet rinore brenda partive politike si struktura që duhen të lehtësojnë përfshirjen e të rinjve nuk arrijnë të krijojnë një bazë të mirë për lideret e ardhshme potenciale. [Përfaqësimi gjinor nëpër forume rinore arrin deri diku mes 30 e 40 përqind, ndërsa ato nuk kanë eliminuar në tërësi praktikën diskriminuese](#).

Viteve të fundit retorika e zotimit për rritjen e barazisë gjinore ka qenë e bujshme. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 kanë parë diskutime për barazinë gjinore si asnjëherë më parë.

Megjithatë, në shumicën e platformave politike dhe programeve zgjedhore të partive politike mungojnë politikat konkrete të propozuara për avancimin e pozitës së grave dhe për arritjen e barazisë gjinore. Pushimi prindëror dhe mbështetja financiare e nënave gjatë pushimit të lehonisë ka qenë çështja më e diskutuar nga secila parti politike si politikë drejt barazisë gjinore. Por, me përjashtim të LVV-së, secila parti tjetër politike ka dështuar të bëjë propozime konkrete për një pushim të ndarë prindëror që do të zvogëlonte diskriminimin në tregun e punës. Përveç kësaj, diskutimet për pushim prindëror kryesisht të drejtuara nga burrat, vetëm sa kanë përforcuar ndarjet tradicionale të roleve gjinore. Megjithatë, Projektligji i ri i Punës iu ofron partive politike një mundësi konkrete për të trajtuar këtë çështje në favor të barazisë gjinore.

Për shkak se zgjedhjet ishin të jashtëzakonshme dhe partitë politike përpiluan listat me kandidatë për deputetë, thuajse në minutat e fundit, përveç ish-deputeteve apo grave që kishin pasur më herët ndonjë post me rëndësi, kandidatet tjera nuk kishin pasur mundësinë të krijojnë ndonjë profil publik. Madje, edhe në rastet kur deputetet gra kanë elektorat të konsoliduar, ato ndeshën me garë të egër nga kolegët e tyre burra; Vjosa Osmani vazhdimisht del deputetja më e votuar në Kuvend. Në 2017, ajo doli e vetmja grua në mesin e 10 deputetëve më të votuar. Megjithatë kryesia e LDK-së e kishte renditur atë në pozitën 81 në listën zgjedhore të koalicionit.

Analizat e programeve televizive tregojnë se [partitë politike u kanë dhënë hapësirë mediale dukshëm më të vogël kandidatëve të tyre gra](#). Në shumicën e rasteve partitë dërgonin nga dy burra në debate. Përkundër hapave të rëndësishëm që janë bërë, përfshirja e grave në politikë dhe në jetën publike është ende shumë e pamjaftueshme. Për të ndryshuar këtë gjendje të shoqëruar me trende negative, kërkohet të merren hapa konkret nga të gjithë akterët institucional e politik.

REKOMANDIMET

- Në pajtim me vlerat kushtetuese të barazisë, Presidenca duhet të tregojë vëmendje të veçantë ndaj çështjeve gjinore dhe të punojë në promovimin dhe arritjen e barazisë gjinore. Presidenti duhet të lansoj iniciativa të veçanta që kanë për qëllim rritjen e përfaqësimit dhe rolit të grave, emëroj gra në kabinetin e tij dhe shtyj përpara reformën zgjedhore.
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme duhet të harmonizohet me Ligjin për Barazi Gjinore në favor të rritjes së përfaqësimit të grave në organet e zgjedhura dhe institucione të tjera. Tetëmbëdhjetë vite pas vendosjes së kuotës së përfaqësimit, ajo duhet të rritet prej 30 në 40 përqind për zgjedhjet e ardhshme, së paku si fazë kalimtare derisa të bëhet harmonizimi i ligjeve për respektimin e plotë të Ligjit për Barazi Gjinore.
- Gjuha diskriminuese dhe fyese ndaj grave në Kuvend duhet të dënohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe deputetët duhet të marrin përgjegjësi për luftimin e gjuhës fyese e diskriminuese. Sanksionimet duhet të definojnë mirë me Rregulloren e Punës së Kuvendit.
- Grupi joformal i grave deputete duhet të jetë më unik dhe proaktiv në avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Me përkrahje të donatoreve, Grupi duhet të krijoj mekanizma për monitorimin dhe raportimin e përfaqësimit gjinor. Organizatat e shoqërisë civile duhet ta mbështesin grupin e grave me aktivitete konkrete.
- Qeveria duhet të ndryshoj praktikën e deritashme të pabarazisë. Përfaqësimi i grave në Qeveri duhet të korrespondojë me nivelin e përfaqësimit të tyre në Kuvend; së paku të korrespondojë me përfaqësimin në legjislaturën prej të cilës Qeveria ka marrë mandatin. Këto rregulla duhet të definojnë me ligjin për Qeverinë i cili është në përgatitje e sipër.
- Ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë duhet të bëjë ndryshimet e nevojshme me urgjencë, me qëllim të përfaqësimit të grave në ekip dhe poashtu të reflektoj përfaqësimin e grave në Kuvend. Përfaqësimi dhe roli i grave duhet të definojnë përmes projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror për dialogun me Serbinë.
- Partitë politike duhet ta rrisin barazinë gjinore brenda subjekteve të tyre, si dhe të hartojnë politika konkrete për barazi dhe çështje gjinore brenda programeve të tyre qeverisëse. Subjektet duhet të caktojnë dhe rrisin kuotën e përfaqësimit gjinor (së paku 40 përqind të grave) dhe të zbatojnë atë në proceset zgjedhore në vijim deri në bërjen e reformës zgjedhore dhe harmonizimin e Ligjit për Zgjedhjet me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Ligji për Barazi Gjinore dhe sanksionet e parapara duhet të zbatohen; të gjithë mekanizmat duhet të veprojnë.



Ky artikull është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është organizatë (Think Tank institute) e pavarur rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza të detajuara të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtimin, konsolidimin institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin evropian dhe reformat politike.

Ne kemi dekada përvojë në hartim, raportim dhe zhvillim të politikave, qasje strategjike dhe avokim tek qeveritë, institucionet ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportimet tona të sakta, të detajuara dhe të paanshme, gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe synojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika për të ardhmen e që janë kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që vendet tona të zhvillojnë shoqëri dhe shtete të fuqishme demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi për Ballkan ka dizajnuar edhe instrumente të reja për të arritur këtë ndryshim, siç janë: Dialogu Politik, Forumi Politik (Forum për Avokim i nivelit të lartë i organizatave Think Tank) dhe Forumi i Shoqërisë Civile për Bashkëpunim Ndërkufitar.

Për më shumë, vizitoni ueb-faqen tonë www.balkansgroup.org ose, na kontaktoni në office@balkansgroup.org



Norwegian Embassy



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION